

10.01.2022
Ora 12:04

RENDI I DITËS


Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr.76 me objekt “Kundërshtimin e vendimit të KSHZ, nr. 470, datë 03.12.2021, “Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura për zgjedhjet e datës 25 prill 2021”, ankuesit: znj.Dasantila Orizaj, znj.Klejda Kuste, z.Fatos Ormenaj, z.Enea Qafa, numërues në KZAZ-në nr.65, Qarku Berat”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. L.Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Meta, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** Numërues të KZAZ-së nr.65: Znj. D. Orizaj,
Znj. K. Kuste, Z. F. Ormenaj, Z. E. Qafa.
Z. Arenc Berati, avokat

Z. L. Braho: Përshëndetje, çelim seancën për shqyrtimin paraprak për Kërkesën Ankimore nr.76, depozituar pranë KQZ-së në datën 31.12.2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.470, datë 3.12.2021 “Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”. Në mbështetje të neneve 19, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe 167, paragrafi i dytë i tij ka vendosur ndër të tjera: Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.01.2022**


dhe e materialit zgjedhor dhe pika 4, të bëj kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara nga anëtarët e grupeve të numërimit sipas listës në Lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ndaj këtij vendimi në zbatim të nenit 124/1, pika 2 të Kodit Zgjedhor kanë paraqitur ankim shtetasit: Dasantila Orizaj, Klejda Kuste, Fatos Ormenaj dhe Enea Qafa, të cilët kanë qenë anëtarët që kanë numëruar votat për qendrën e votimit 3305/2 që i përket KZAZ-së nr. 65, Qarku Berat. Në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, kjo kërkesë ankimore është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore me nr. 76 të regjistrit, datë 31.12.2021. Në zbatim të nenit 12 të Rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të KAS”, në datën 05.01.2022 është hedhur shorti për të përcaktuar relatorin e shqyrtimit të kësaj kërkesë ankimore, nga e cila u caktua relator anëtari Ledio Braho. Si fillim për prezencën e palëve. Ju lutem një prezantim duke qenë se janë katër ankimues. Ankimi është depozituar me avokat. Ju lutem identifikimi i secilit prej jush!

Znj. D. Orizaj: Dasantila Orizaj, kryetare e tavolinës për numërimin e qendrës së votimit 3305/2.

Znj. K. Kuste: Përshëndetje të gjithëve, Klejda Kuste, anëtare e tavolinës së numërimit, identifikuar me nr.identifikimi J25401091R.

Z. F. Ormenaj: Fatos Ormenaj, sekretar i GNV nr. 8 të KZAZ-së nr. 65, për qendrën e votimit 3305/2, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.01.2022*

Z. A. Berati, avokat: Përshëndetje, unë jam avokat Arenc Berati dhe ankuesit më kanë zgjedhur që t'i përfaqësoj përpara jush. Kjo do të bëhet nëpërmjet deklaramit të tyre.

Z. L. Braho: Faleminderit, po për anëtarin tjetër Enea Qafa?

Z. A. Berati, avokat: Është duke ardhur.

Z. L. Braho: Dakord! Gjithashtu e pranishme është dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Ylli Merkaj. Përpara se të fillojmë me raportimin nga Sekretari i Përgjithshëm, ka ndonjë pretendim nga palët në lidhje me konfliktin e interesit nga anëtarët e KAS-it? Atëherë i pranishëm është dhe Enea Qafa, që ishte ankuesi i katërt. Ju keni qenë në cilësinë e anëtarit të GNV-së?

Z. E. Qafa: Po!

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Zoti Merkaj, mund të na bëni një përmbledhje të shkurtër të situatës në lidhje me këtë çështje. Pra, nga sa kam kuptuar unë, kemi të bëjmë me një vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që pas këqyrjes që i është bërë njërës nga qendrat e votimit të KZAZ-së nr. 65 që i përket Qarkut Berat. Kjo është një qendër votimi që nga rinumërimi i fletëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve., më konkretisht fletëve për kandidatë me sa kam kuptuar unë, ka ndryshim të rezultatit. Duke u bazuar dhe tek një raport statistikor që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka bërë në lidhje me të gjitha kutitë që janë hapur pas mbylljes së procesit dhe pas certifikimit të rezultatit, ka rezultuar që në këtë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.10.01.2022

qendër votimi, ka pas një ndryshim të madh të atillë që sipas Komisionerit konsiderohet që jemi në kushtet e kryerjes së veprës penale. Për këtë ai ka drejtuar një kallëzim penal prokurorisë. Mund të na relatoni më shumë dhe në lidhje me rezultatet e kësaj qendre votimi? Si kanë qenë? Të paktën nga ankimuesit pretendohet se kjo kuti është hapur dhe nga KAS gjatë procesit të shqyrtimit të ankimeve. Gjithashtu është hapur dhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në bazë të Udhëzimit nr.15.

Z. Y. Merkaç: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 470, datë 3.12.2021 ka miratuar "Raportin mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021". Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri ka vendosur për miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor. Ka miratuar raportin për këqyrjen paszgjedhore për KZAZ-në nr. 40, Qarku Tiranë dhe për qendrat e votimit sipas Lidhjes nr. 1 të Vendimit nr. 470. Gjithashtu në pikën 4 të këtij vendimi, ka vendosur të bëjë kallëzim penal pranë organit të prokurorisë për shkelje të konstatuara për anëtarë të GNV-ve sipas Lidhjes nr. 4, ku bën pjesë edhe KZAZ-ja nr. 65 për qendrën e votimit 3305/2. Duke mos qenë dakord me këtë vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, katër anëtarë të GNV-së kanë bërë ankim brenda afatit ligjor në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Duke qenë se jemi në shqyrtimin paraprak, mendoj se kërkesa e depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga katër anëtarët e grupit të numërimit, plotëson kriteret e caktuara në nenin 124 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Është bërë nga persona që kanë interes për çështjen dhe cënohen nga vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. I është drejtuar KAS-it si organi kompetent

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.01.2022*

për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe është brenda afatit të ankimit. Në lidhje me pyetjen tuaj në qoftë se do të vazhdojmë më poshtë. Gjatë këqyrjes paszgjedhore, anëtarët e GNV të ngritur pranë KQZ-së kanë verifikuar fletët e votimit dhe konkretisht listën e kandidatëve për deputetë të QV-së nr. 3305/2 dhe kanë konstatuar që në KZAZ-në nr. 65 ka pas ndryshime midis vlerësimit të votave që kanë bërë katër ankuesit me vlerësimin që ka bërë GNV-ja e ngritur në KQZ. Kjo diferencë ka qenë më shumë se 30 vota. Duke qenë se është diferencë shumë e madhe dhe është vlerësuar nga Komisioneri se nuk është më gabim njerëzor, pasi 30 vota janë një numër i konsiderueshëm. Është gjykuar që është një veprim i bërë me dashje, me qëllim dhe jo gabim njerëzor. Në këto kushte të gjithë anëtarët e grupeve të numërimit, jo vetëm të KZAZ-së nr. 65, por për të gjithë anëtarët që janë listuar në Lidhjen nr. 4 të vendimit është bërë kallëzim penal. Pasi siç e thashë më lart është konsideruar si gabim i qëllimshëm dhe jo gabim njerëzor.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Merkaj, besoj se katër ankuesit do të përfaqëohen nga avokati, kështu që.. Avokat seanca e sotme është seancë për verifikimin paraprak të kërkesës ankimore që lidhen me kritere si kompetenca e KAS-it, legjitimimi i ankuesit dhe respektimi i afateve ligjore. Çfarë keni për të thënë në lidhje me këtë çështje dhe pastaj kam unë një pyetje pasi të përgjigjeni për këtë pjesë.

Z. A. Berati, avokat: Faleminderit, mendoj se kërkesa e paraqitur i përmbush të gjitha kriteret e parashikuara nga Kodi Zgjedhor duke i ndarë ato përsa i përket së pari, legjitimitit të palëve, nëse janë këta palë që duhet të paraqesin një kërkesë para KAS-it. Të katërt ankuesit legjitimohen për shkak të funksionit që kanë pas në momentin kur kanë numëruar kutitë e qendrës së votimit nr. 3305/2 të KZAZ-së nr.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 10.01.2022*

65, Qarku Berat. Gjithashtu legjitimohen edhe për faktin tjetër se nga vendimi i marrë që ka miratuar raportin cënohen në mënyrë të drejtë për drejtë duke ju vendosur një sanksion i cili ka të bëjë me një kallëzim penal. Është paraqitur brenda afatit ligjor, brenda 30 ditëve dhe kanë paraqitur të gjitha shkaqet ligjore për të cilat kërkojnë që vendimi për sa i përket QV-së nr. 3305/2 në KZAZ-në nr. 65, Qarku Berat nuk është i drejtë. Arësyet janë përmendur në ankim. Besoj se ato i përkasin çështjes së themelit.

Z. L. Braho: Faleminderit, ndonjë pyetje nga kolegët si për administratën edhe për palët? Diçka para se të fillojmë, të katërt jeni dakord të përfaqësoheni nga avokati Berati në prani dhe në mungesë të tij?

Znj. D. Orizaj: Dakord!

Znj. K. Kuste: Dakord!


Z. F. Ormenaj: Dakord!

Z. E. Qafa: Dakord!

Z. L. Braho: Ndonjë pyetje nga kolegët? Kam unë një pyetje, si fillim për administratën e KQZ-së. Zoti Merkaj, kallëzimet penale janë depozituar në prokuroritë përkatëse?

Z. Y. Merkaj: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.10.01.2022

Z. L. Braho: Keni ndonjë informacion që nga depozitimi i ankimeve, në qoftë se këto janë regjistruar apo jo nga prokuroria?

Z. Y. Merkaj: Jo nuk kemi, sepse i kemi nisur me postë, nuk kemi informacion.

Z. L. Braho: Dakord! Zoti Berati, ankimuesit kanë ndonjë informacion tjetër përveç vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me këtë procedurë? Pra, sa është ndryshimi i votave që ka rezultuar nga numërimi që kanë bërë numëruesit me atë që është bërë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve?

Z. A. Berati, avokat: Faleminderit i nderur! Siç e kemi trajtuar edhe në kërkesë, së pari nuk kanë pas asnjë dijeni..

Z. L. Braho: Dakord për atë pjesë, dua të di sot a kanë ndonjë informacion?

Z. A. Berati, avokat: Nuk kanë pas dijeni dhe as sot nuk kanë asnjë lloj dijenie që janë para jush.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit!

Z. I. Rusmali: Kam diçka që ndoshta duhet sqaruar dhe për ne, pavarësisht se ka lidhje me përmbajtjen, por ka lidhje dhe me kompetencën tonë. Ju kërkoni pavlefshmëri absolute. Me aq sa kuptoj unë, për shkak kryesor të faktit që qendra e votimit që kanë numëruar numëruesit është numëruar në procedurë ankimore nga KAS-i dhe ju thoni që ligji ndalon kryerjen e procedurës së verifikimit kur qendra është numëruar në procedurë ankimore. Gjetjet në raport me të katër numëruesit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.01.2022*

kanë lidhje me numërimin e votave preferenciale. Në rastin në fjalë, KAS-i ka numëruar dhe votat preferenciale, apo vetëm ato të subjekteve?


Z. A. Berati, avokat: Faleminderit! Së pari, duke qenë se kemi të bëjmë me vota preferenciale, ajo dihet që kur janë numëruar votat, fillimisht numërohen votat për partitë. Duke qenë se votat preferenciale, fillimisht janë numëruar si vota për partitë. Në këtë kontekst, mendoj se këtu kemi të bëjmë pikërisht me cënimin e të drejtës. Pra, duke qenë se janë hapur kutia e fletëve të numërimit, janë numëruar, pavarësisht numërimit për subjekt, në mënyrë të drejtë për drejtë ato cënojnë edhe kandidatin. Pra, përderisa janë hapur dhe udhëzimi e ka dhënë të qartë që nuk mundet t'i nënshtrohen procesit të numërimit për herë të dytë. Në një farë mase, vetë Komisioneri e ka parashikuar që të mos kemi cënimin për herë të dytë, sepse humbet siguria juridike. Janë numëruar nuk mund të numërohen. Parimi i gjësë së gjykuar. Ata mund ta kishin konstatuar që në momentet e para. Për më tepër në qoftë se do të shohim më pas materialet do të shohim që janë të panënshkruar nga komisioni që ka numëruar. Nuk janë të vendosura as kodet e sigurisë së kutisë. Çfarë do të thotë që ne i kemi të pagarrantuara cilat janë fletët që janë numëruar? Cilat janë fletët që janë depozituar dhe pse janë depozituar në atë formë dhe nuk janë pasqyruar në tabelën e rezultateve. Ato ua kemi bashkangjitur me ankimin, faleminderit!

Z. K. Bele: Më falni mundem, për ta kuptuar, në plotësim të.., pra ju i referoheni kësaj pikës që flet për materialin zgjedhor të këqyruar?

Z. A. Berati, avokat: Materialit paszgjedhor...

Z. K. Bele: Aha materialit zgjedhor të këqyruar më pas.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.01.2022*

Z. A. Berati, avokat: Udhëzimi nr. 15, dt.7.10.2021, ka parashikuar që nuk lejohet këqyrja e fletëve të votimit, ose materialeve zgjedhore që është këqyrrur më parë kryesisht, ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore përgjatë procesit të ankimimit.

Z. K. Bele: Më fal Avokat, për të ndihmuar. Fletët e votimit ne qartësisht nuk i kemi numëruar, bëhet fjalë për kandidatë gjithmonë. Ndërkaq në kuptueshmërinë time, ne kemi këqyrrur materialin zgjedhor në atë proces, përveç fletëve të subjektit. Pra, mbivendosja sipas jush është tek pjesa e materialit zgjedhor?

Z. A. Berati, avokat: Po patjetër!


Z. K. Bele: E kuptova drejt. Kam dhe një pyetje në fakt për të kuptuar fazën e procesit, pa paragjykuar të drejtën e KAS-it për të ndërhyrë në këtë pjesë. A janë bërë kallëzimet penale ndërsa ne flasim për grupin e numërimit?

Z. Y. Merkaj: Po janë depozituar në prokuroritë përkatëse.

Z. K. Bele: Dakord, faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, KAS-i do të tërhiqet për vendim, na prisni rreth 15 minuta dhe do t'u thërrasim sërish për vendimmarrjen e shqyrtimit paraprak.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.10.01.2022

Rifillon seanca

Ora 12:38

Atëhere, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, vendosi:

Pranimin pjesërisht për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr. 76, dt.31.12.2021 të paraqitur nga ankimesit Dasantila Orizaj, Klejda Kuste, Fatos Ormenaj dhe Enea Qafa. Më konkretisht, pranimin për shqyrtim të kërkesave nga numri 1 deri në numërin 5.

Moskalimin për shqyrtim të pikës 6 të kërkesës që ka të bëjë me shfuqizimin e pikës 4 të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, objekt i këtij shqyrtimi administrativ që ka të bëjë me çështjen e kallëzimit penal.

Për ta sqaruar, është një qëndrim që KAS-i e ka mbajtur dhe më parë, pasi është neni 281 i “Kodit të Procedurës Penale” që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka detyrimin ligjor dhe që është e drejta e tij e ligjshme si nëpunës civil dhe për këtë pjesë ne nuk mund të marrim vendim. Për gjithë pjesën tjetër, për pikat nga nr. 1 deri në nr. 5 do ta kalojmë për shqyrtim. Unë do t’i kërkoja administratës të na verë në dispozicion ne, por dhe palës të gjitha procesverbalet që i takojnë kësaj qendre votimi. Duke nisur që nga numërimi nga ankuesit deri tek rinumërimi që është kryer në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në bazë të procesit që po shqyrtojmë. Sa kohë i duhet administratës për të përgatitur këto akte?

Z. Y. Merkaç: 3 - 4 orë.

Z. L. Braho: Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të bëhet në datën 12.01.2022 në orën 12:00. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Seanca mbyllet!

Vendimi nr. 3

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



10.01.2022

Ora 12:42

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për mospranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr. 01
“Kundërshtim i vendimit nr. 470, dt.03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve, ankues zoti Durim Alla”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:**

Z. I. Rusmali: Fillojmë shqyrtimin paraprak të Kërkesën Ankimore nr. 01, dt.05.01.2022 të paraqitur nga Durim Alla, i cili pavarësisht se nuk e sqaron këtu, duhet të jetë numëruar për QV nr. 2796 për KZAZ-në nr. 53. Ankuesi është njoftuar rregullisht nga administrata e KQZ-së? Nuk është prezent në këtë seancë të shqyrtimit paraprak. Janë prezent përfaqësuesit e administratës së KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm dhe ekipi. Objekti i kërkesës siç rezulton nga leximi i saj, kërkesa është kundër vendimit 470, datë 3.12.2021 dhe kërkon në fakt dhe në kërkesë, shfuqizimin e pikës 4 të vendimit. Pra, pikës për kallëzimin penal. Administra, çfarë mendimi keni? A është në përputhje me elementët e formës?

Z. Y. Merkaj: Po, nga konstatimi paraprak i kërkesës së paraqitur nga ankuesi Durim Alla, kërkesa është në përputhje me nenin 124 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, pasi plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes së një kërkesë ankimore. Është drejtuar nga një numëruar dhe preket direkt nga vendimi nr. 470, dt.03.12.2021 i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.01.2022*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. I është drejtuar KAS-it si organi administrativ i cili shqyrton kërkesat kundër vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Është paraqitur brenda afatit ligjor dhe legjitimohet ankuesi i kësaj kërkesë administrative. Plotëson kërkesat e nenit 130 të Kodit Zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Nga ana e KAS-it ka dy vendimmarrje praktikisht tani, të cilat konfirmojnë faktin që shprehja e vullnetit nga ana e Komisionerit për të bërë kallëzim penal, në rastet kur ai nga dokumentacioni administrativ konstaton elementë të veprave penale, nuk është çështje kompetence, por është detyrimi ligjor që ka Komisioneri në bazë të “Kodit të Procedurave Penale”. Ai e ushtron këtë detyrim ligjor në linjë të plotë nga ana e tij, pa pasur nevojë t’ia nënshtrojë procedurave të shqyrtimit administrativ. Për të bërë detyrën sipas “Kodit të Procedurës Penale”, Komisioneri nuk ka nevojë të kërkojë as autorizimin e KAS-it dhe as që t’ia shtrojë për shqyrtim KAS-it nëse është dakord për kryerjen e kallëzimeve penale. Komisioneri ndërkohë, besoj dhe për këtë e ka depozituar kallëzimin penal, apo jo zoti Sekretar i Përgjithshëm?

Z. Y. Merkaj: Po është depozituar.

Z. I. Rusmali: Pra, Komisioneri e ka depozituar kallëzimin penal, gjë që praktikisht e bën të paefektshëm shqyrtimin administrativ të kësaj kërkesë. Ankuesi ka gjithë të drejtën dhe instrumentat ligjore që në kuadër të procedimit penal të mbrojë të drejtat e tij dhe të ngrejë të gjitha pretendimet që ka në raport me gjetjet që Komisioneri ka parashtruar në kallëzimin e tij penal. Besoj se kolegët janë të gjithë dakord që ne do t’i qëndrojmë besnikë praktikës së vendosur po nga ne, që kjo çështje nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, sepse nuk është kompetencë e jona ankimimi ndaj kësaj pike.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.10.01.2022

KAS-i në përfundim vendosi njëzëri: mospranimin për shqyrtim edhe të kësaj kërkesë për shkaqet që tashmë janë bërë të njohura dhe në vendimmarrjen tonë. E mbyllim shqyrtimin, faleminderit!

Vendimi nr. 4

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

